



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Prishtinë, 28 korrik 2010
Nr. ref.: RK 59/10

VENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 62/09

Sadik Shemë Bislimi

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbëre nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Z. Sadik Shemë Bislimi, me banim në Ferizaj.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi ka dorëzuar një kërkesë duke kërkuar nga Gjykata "të vlerësojë ligjshmërinë e ligjeve dhe të drejtësisë në gjyqet dhe organet administrative shtetërore të Kosovës"
3. Në përgjithësi, parashtruesi ofron pikëpamjen e tij për çështjet social dhe politike "gjatë dekadës së fundit" pa siguruar një rast të plotë dhe të qartë për shkeljen përkatëse.

Baza Juridike

4. Neni 113 (7) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëlutjeshëm: "Kushtetuta"), Nenet 20 dhe 22 (7) dhe (8) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëlutjeshëm "Ligji") dhe Neni 54 (b) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëlutjeshëm "Rregullorja e Punës").

Procedura para Gjykatës

5. Më 20 dhjetor 2009, parashtruesi e ka dorëzuar Kërkesën në Gjykatë duke kërkuar që Gjykata duke "të vlerësojë ligjshmërinë e ligjeve dhe të drejtësisë në gjyqet dhe organet administrative shtetërore të Kosovës."
6. Më 16 korrik 2010 Kolegji Shqyrtues, në përbërje të gjyqtarës Snezhana Botusharova (Kryetare), Ivan Čukalović dhe Kadri Kryeziu, kanë shqyrtuar Raportin e Gjyqtarit Raportues dhe i kanë ofruar një rekomandim Gjykatës në lidhje me papranueshmërinë e Kërkesës.

Faktet

7. Parashtruesi pretendon që më 1 gusht 1992 ai "është shpallur pensionist invalidor me përvojë pune 38 vjeçare" që përfiton një pension në bazë të kontribut, të cilin ai e e pagoi deri më 15 gusht 1998.
8. Duke filluar më 15 gusht 1998 deri më 5 maj 2003, atij i është mohuar një pension i tillë dhe nga data kur ka mbushur 65 vjeç ai ka marrë 25-40 EURO si lëmshë, pra ngjashëm si ata persona që nuk kanë punuar asnjë ditë pune në jetën e tyre dhe që asnjëherë nuk kanë paguar ndonjë kontribut pensional. Prej 1 janarit 2007, ai prapë "është paguar 75 EURO lëmshë në emër të pensionit" dhe nga 1 janarit 2008, ai prapë "është paguar 80 EURO lëmshë."
9. Për më shumë, parashtruesi pretendon që më 1 tetor 2001 ai ka kërkuar nga Gjykata Komunale të dëmshpërblejë atë "në shumën prej 2.630,80 DM ose të këmbëra në euro, 1.200,00 EURO".
10. Më 8 shkurt 2008, Gjykata Komunale në Ferizaj vendosi "të kompensojë dëmin por pala që është dashur të paguajë kompensimin nuk është pajtuar me vendimin dhe ka apeluar vendimin."
11. Ai më tutje deklaron që rasti i tij ka mbetur në Gjykatën e shkallës së dytë në Prishtinë "për 2 vitet e fundit."
12. Parashtruesi i referohet Gjykatës Komunale në Ferizaj për "mosmarrëveshjen e blerjes së tokës (...) për një parcelë në sipërfaqe prej 10.383 m²", dhe që "kjo sipërfaqe nuk është definuar mirë."
13. Parashtruesi ka transferuar 1/3 e parcelës prej 31.160 m², që do të duhet të ndahet në tri pjesë të barabarta dhe kjo do të thotë që 1/3 e kësaj sipërfaqe është 10.383 m², dhe "që kjo sipërfaqe nuk duket se është ashtu."
14. Ekspertë të ndryshëm të gjeodezisë kanë vlerësuar parcelën dhe i kanë dorëzuar gjetjet me shkrim në Gjykatën Komunale të Ferizajt. Në fakt më 18 mars 2005, eksperti i parë ka llogaritur 1/3 e kësaj sipërfaqe për 09.000 m².

15. Pastaj Gjykata Komunale në Ferizaj "ka propozuar një super-ekspertizë, me 2 super-ekspertë të tjerë." Këta ekspertë kanë propozuar që sipërfaqja e tokës është 08.600 m².
16. Për këto arsye "rasti është vendosur në favor të palës paditëse, d.m.th në sipërfaqe prej 08.600 m², dhe jo siç do të duhej të ishte, pra 10.383 m²."
17. Përfundimisht, parashtruesi deklaron që ai ka respektuar kontratën e tij për shërbimet e energjisë elektrike me KEK-un dhe që rregullisht ka paguar faturat për rrymën e harxhuar, edhe pse KEK-u ka shkaktuar dëme të mëdha me furnizim të dobët dhe të çrregullt me energji elektrike, përfshirë ndërprerjen e energjisë elektrike pa paralajmërim për klientët.
18. Në lidhje me këto dëme të pretenduara, parashtruesi është ankuar tek Drejtori i KEK-ut, me sa duket së paku dhjetë herë, ndërsa herën e fundit është ankuar më 3 tetor 2009, që sipas Parashtruesit nuk ka pasur përgjigje në ankesat e tij.
19. Ai po ashtu ka "shkuar në Gjykatën Komunale të Ferizajt me kërkesëpadinë e dërguar me postë" më 28 dhjetor 2007, duke pretenduar "që ky dëm është shkaktuar nga furnizimi i dobët me energji elektrike dhe për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të rrymës vetëm gjatë një ditë, pa paralajmërim, dhe që kjo do të thotë se administrata e KEK-ut nuk respekton ligjet" dhe që "nuk zbaton obligimet e përcaktuara nga vetë KEK-u në bazë të kontratës Nr. 10508, të datës 27.02.2003".
20. Parashtruesi po ashtu pohon që mbledhja e 3,5 Eurove për RTK, nëpërmjet faturave të energjisë elektrike, është në kundërshtim me kushtetutën. Parashtruesi argumenton që ai as nuk është pajtuar dhe as nuk ka nënshkruar kontratë për shërbimet e RTK-së dhe prandaj nuk mund të detyrohet të paguajë këtë pagesë.
21. Përfundimisht, Parashtruesi pretendon që ai është një ndër 10.000 qytetarët e Kosovës që kanë nënshkruar një peticion për të kundërshtuar një ngritje të çmimit të energjisë elektrike nga KEK-u në vitin 2009. Parashtruesi pohon që Kryetari i Kuvendit ka shpërfillur këtë peticion, përkundër obligimit ligjor për të shqyrtuar atë.

Pretendimet e parashtruesit

22. Më konkretisht, parashtruesi:
 - a. pyet "përse nuk është zbatuar Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor që 10 vitet e fundit dhe përse nuk janë zbatuar Ligji për Sigurimin Shëndetësor dhe Ligji për Punën." Parashtruesi konsideron që "pensioni duhet të garantohet me të ligjet ndërkombëtare, pa marrë parasysh shtetin ku një person kontribuon me punë dhe që pensioni duhet të paguhet sipas meritës."
 - b. pretendon që "një konflikt administrativ (...) është vendosur më 8 shkurt 2008 [në Gjykatën Komunale të Ferizajt] por pala që është dashur të paguajë kompensimin nuk është pajtuar me vendimin dhe ka apeluar vendimin, dhe se ky rast është duke u shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë në Prishtinë, që ende nuk ka përfunduar shqyrtimi edhe pse ky rast ka qenë i thjeshtë për tu vendosur."
 - c. parashtruesi i referohet Gjykatës Komunale në Ferizaj për "mosmarrëveshjen e blerjes së tokës (...) për një parcelë në sipërfaqe prej 10.383 m²", dhe që "kjo sipërfaqe nuk është definuar mirë."
 - d. përfundimisht, kërkon që Gjykata "të anulojë dhe refuzojë udhëzimet e liderëve të lartë të vitit 2003, duke i bërë kështu organet e KEK-ut shërbëtor për mbledhjen e pagesës mujore prej 3,5 Eurove për RTK-në duke filluar më 1 nëntor 2003, gjë e cila është tërësisht joligjore".

23. Parashtruesi përfundon deklaratën e tij duke thënë: “Unë kërkoj mjete juridike dhe këshillë se çfarë duhet bërë (...) për të gëzuar të drejtat e mia të mohuara.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së Kërkesës

24. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për Kërkesën e Parashtruesit, Gjykata së pari duhet të kontrollojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe më tutje të specifikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.
25. Sa i përket çështjes së parë, përkatësisht pyetjes se përse disa ligje nuk janë miratuar, Gjykata rithekson që individët janë të autorizuar të paraqesin në Gjykatë shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre themelore, të garantuara me Kushtetutë, nga autoritetet publike. Megjithatë, ata duhet të përmbushin disa kushte të përcaktuara me ligj. Një prej këtyre kushteve është: “vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.” Këto fjalë qartazi tregojnë për natyrën kufizuese të këtij parimi kushtetues.
26. Sa i përket kësaj pretendimi, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar që ai ka shteruar çfarëdo mjeti juridik, që atij i është vënë në dispozicion në bazë të ligjit të zbatueshëm, apo që mjete të tilla juridike do të ishin joefektive.
27. Për më shumë, Parashtruesi as nuk paraqet argumente bindëse që i janë shkelur të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejt dhe aktualisht nga ndonjë autoritet publik, dhe as nuk thekson ndonjë vendim të formës së prerë që ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me Kushtetutë.
28. Përveç kësaj, mungesa e një vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet publik konkret shpie në konstatimin që ai nuk është palë e autorizuar për të ngritur çështjen se përse disa ligje ende nuk janë miratuar. Prandaj ky pretendim është i papranueshëm.
29. Sa i përket çështjes së dytë, që ka të bëjë me konflikt administrativ (...) në Gjykatën Komunale të Ferizajt, parashtruesi deklaron që ky rast është ende në gjykatën e shkallës së dytë në Prishtinë “për 2 vitet e fundit”. Pra është e qartë se një vendim i formës së prerë ende nuk është marrë dhe që të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj ende nuk janë shterur. Prandaj ky pretendim është i papranueshëm.
30. Sa i përket çështjes së tretë, që është konflikt lidhur me parcelën në sipërfaqe prej 10.383 m², parashtruesi i kërkesës deklaron që rasti është vendosur [nga Gjykata Komunale në Ferizaj] në favor të palës paditëse, d.m.th në sipërfaqe prej 08.600 m², dhe jo siç do të duhej të ishte, pra 10.383 m².
31. Po ashtu, rezulton që nuk është parashtruar asnjë ankesë në ndonjë shkallë tjetër gjyqësore dhe që vendimi është i formës së prerë. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës nuk pretendon ndonjë shkelje konkrete dhe as nuk bashkëngjit kërkesës informatat dhe dokumentacionin mbështetës për të dëshmuar një pretendim të tillë. Siç duket parashtruesi i kërkesës në fakt nuk ka kundërshtuar apo apeluar kundër ndonjë shkelje dhe prandaj ka hequr dorë nga e drejta që tani të paraqes ndonjë shkelje, para kësaj Gjykate.
32. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk përmbush kushtet zyrtare për procedim të mëtutjeshëm dhe për këtë arsye është e papranueshme.

33. Përfundimisht, sa i përket çështjes së fundit e që me mbledhjen e pagesës prej 3,5 Euro për RTK-së, nëpërmjet faturave për energji elektrike, parashtruesi nuk specifikon se cilat të drejta dhe liri atij i janë shkelur.
34. Gjithashtu, parashtruesi nuk ofron ndonjë dëshmi që ai ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion në lidhje me mbledhjen e pagesës së RTK-së apo petitionit kundër ngritjes së çmimit të energjisë elektrike nga KEK-ut.
35. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton që, në pajtim me Nenin 22 (7) të Ligjit, kjo pjesë e Kërkesës nuk përmbush kushtet zyrtare për procedim të mëtutjeshëm. Për këtë arsye, pretendimi është i papranueshëm.
36. Në përgjithësi Gjykata gjen që, pretendimet e paraqitura në Kërkesën e dorëzuar nga Parashtruesi, nuk përmbushin kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, Nenet 46-48 të Ligjit dhe Nenin 69 të Rregullores së Punës. Prandaj, Kërkesa refuzohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të Nenit 48 të Ligjit dhe të Nenit 54 (b) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese, në seancën e datës 28 korrik 2010, njëzëri:

VENDOS

- I. TA REFUZOJ Kërkesën si të papranueshme.
- II. Në pajtim me Nenin 20 (4) të Ligjit, ky Vendim do t'iu komunikohet Palëve dhe do të shpallet në Gazetën Zyrtare.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Almiro Rodrigues, d.v.



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.